



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BUJQËSISË, MBROJTJES SË MJEDISIT, VETERINARISË,
PYJE DHE KULLOTA

Nr. 5259 prot.

Vlorë, më 02.04.2025

KONTRATË

PËR

SHFRYTËZIMIN E LËNDËS DRUSORE (PYLLI I SODËS)

Në Bashkinë Vlorë, sot më datë 28.03.2025 në zbatim të Ligjit Nr. 57/20 datë 30.04.2020 “Për Pyjet ” , të Ligjit Nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të Pyjeve në Republikën e Shqipërisë”, të VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në pronësi të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar me V.K.M Nr. 684 datë 20.09.2020, V.K.M Nr. 438 datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”, të Udhëzimit të MM Nr.2 datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup-ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime, me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarritpër ngrohje.” , V.K.M Nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhime drusore dhe jo drusorepyjore” lidhet kjo kontratë midis:

I. PALËT:

1. Bashkia Vlorë, e përfaqësuar nga Kryetari Bashkisë z. Ermal Dredha.
2. Subjekti “Merilin Gjini”, person Fizik me nr.(NUIS) L64005402V, përfaqësuar nga përfaqësuesi z.Valentin Gjini me prokurë me nr. rep: 1875, nr. kol: 1022.

II. OBJEKTI:

Kontrata ka për objekt shfrytëzimin e lëndës drusore, në ngastrat, n/ngastrat si më poshtë:

Ekonomia Pyjore	Nr. ngastrës, n/ngast rës	Lloji drusor	Lëndë Punimi m ³			Dru zjarri m ³	Totali m ³
			hollë	mesme trashë	Totali		
Kume-Shashicë	10a total	P,e	4.888	11.318	16.206	51.404	67.61
Kume-Shashicë	10b	P,e	1.289	4.952	6.241	17.8	24.041
Kume-Shashicë	17	P,e	0.754	3.229	3.983	0.298	4.281
Kume-Shashicë	18b	P,e	1.362	3.139	4.501	12.206	16.707
Kume-Shashicë	18a	P,e	4.375	30.153	34.528	23.401	57.929
Kume-Shashicë	11b2	P,e	0.242	0.972	1.214	4.712	5.926
Kume-Shashicë	13a	P,e	0.56	1.502	2.062	5.494	7.556
Kume-Shashicë	13b	P,e	1.058	5.308	6.366	20.819	27.185
Kume-Shashicë	11a	P,e	0.853	2.645	3.498	13.771	17.269
Kume-Shashicë	13b	P,e	10.88	30.909	41.789	16.272	58.061
Kume-Shashicë	13c	P,e		0	0	4.55	4.55
Kume-Shashicë	14	P,e	2.576	12.034	14.61	18.489	33.099
				0	0		0
			28.837	106.161	134.998	189.216	324.214

III. AFATI:

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj, më datë 02.04.2025 dhe përfundon më datë 30.07.2025.

IV. DETYRIMET E PALËVE:

A. Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Vlorë.

1. Ndjek zbatimin e projektit teknologjik të shfrytëzimit, përcakton vendin e depozitimit të materialit drusor për marketimin dhe stivosjen e tij.
2. Jep lejet e shfrytëzimit menjëherë pas paraqitjes së dokumentit të pagesës së plotë të këstit të radhës dhe pas shlyerjes së detyrimeve të shfrytëzimit të pjesës së paguar në këstin paraardhës.

3. Jep vërtetimet e transportit të materialit drusor sipas kërkesës me shkrim të subjektit pas marketimit të asortimenteve dhe pas plotësimit nga ana e tij e dokumentit shoqërues të mallit dhe të distinsës së asortimenteve.

4. Kontrollon periodikisht aktivitetin e subjektit dhe kur konstaton shkelje, mban proces-verbalin përkatës.

5. Pas përfundimit të shfrytëzimit të çdo pjese të ngastrës, mban proces-verbal kolaudimi provizor dhe në përfundim të shfrytëzimit të ngastres, n/ngastres, i merr ato në dorëzim me proces-verbal kolaudimi përfundimtar.

6. Nuk mban përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve në vartësi të Bashkisë.

7. Nuk mban asnjë përgjegjësi për vrejtjet që mund të ketë subjekti pas nënshkrimit të kontratës, gjatë gjithë periudhës së prodhimit, lidhur me sasinë dhe cilësinë e lëndës drusore të shitur, që përmbajnë njësitë e mbarështimit të fituara në ankand.

8. Për mosrespektimin e detyrimeve kontraktore, si dhe të kërkesave të Udhëzimit Nr.2 datë 03.03.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup-ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime, me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje.”, merr masa si: pezullon shfrytëzimin, kërkon zbatimin e kërkesave teknike, deri në zgjidhjen e kontratës.

B. Të drejtat dhe detyrimet e subjektit:

1. Fillon prerjen e drurëve të secilës pjesë, pas pajisjes me lejen përkatëse të shfrytëzimit të lëshuar nga Bashkia dhe proces-verbalin e marrjes në dorëzim.

2. Brenda ngastrës, n/ngastrës që ka marrë në dorëzim, respekton afatet e punimeve për prerjen, prodhimin, pastrimin e ngastrës, kolaudimin provizor e atë përfundimtar dhe evadimin e materialit drusor, të detajuar si më poshtë:

a. Në ngastrën nr. 17,nr.18ab,nr.13 a,nr13b, nr.13c, nr,10a,nr.10b,nr. 11b2 ekonomia pyjore Kume-Shashicë.

- Fillon prerjen dhe prodhimin në datën 03.04.2025 dhe e përfundon në datën 25.05.2025.

-Nxjerrjen e materialit drusor nga brenda ngastrës dhe pastrimin e përfundon në datën26.05.2025

- Kolaudimin e ngastrës e bënë në datën 30.05.2025.

- Evadimin e materialit drusor nga ngastra deri në destinacion e përfundon në datën 30.05.2025

b. Në ngastrën 13 a,nr13b, nr.13c, nr, ekonomia pyjore Kume-Shashicë .

- Fillon prerjen dhe prodhimin në datën 01.10.2025 dhe e përfundon në datën 30.12.2025.

-Nxjerrjen e materialit drusor nga brenda ngastrës dhe pastrimin e përfundon në datën 30.12.2025

- Kolaudimin e ngastrës e bënë në datën 31.12.2025.

- Evadimin e materialit drusor nga ngastra deri në destinacion e përfundon në datën 31.12.2025

b. Në ngastrën , nr,10a,nr.10b nr. , 11b2 ,14 ekonomia pyjore Kume-Shashicë .

- Fillon prerjen dhe prodhimin në datën 01.10.2025 dhe e përfundon në datën 30.12.2025.

-Nxjerrjen e materialit drusor nga brenda ngastrës dhe pastrimin e përfundon në datën 30.12.2025

- Kolaudimin e ngastrës e bën në datën 31.12.2025.

- Evadimin e materialit drusor nga ngastra deri në destinacion e përfundon në datën 31.12.2025

3. Nxjerr brenda ditës në anë të rrugës asortimintet trupa dhe lëndën e rrumbullaket dhe bën marketimin e tyre me bojë vaji, ndërsa drutë e zjarrit brenda 7 ditëve duke i stivosur ato në anë të rruges, stivat shënohen me gëlqere ose bojë vaji të dallueshme, ku shënohet edhe sasia përkatëse. Marketimi i asortimenteve drusore (trupa, lëndë ndërtimi, shtylla miniere, dru zjarri, etj) do të bëhet me bojë vaji me ngjyrë të kuqe.

4. Dorëzon cdo fund 15 ditori, materialin drusor të prodhuar sipas asortimenteve dhe pas marketimit të tyre bën transportin me vërtetim transporti.

5. Deklaron cdo fillim muaji pranë Drejtorisë Rajonale të IKMT Vlorë numrin e mjeteve, tipin e targën e tyre, me të cilat do të bëjë transportin e materialit drusor.

6. Pajiset me vërtetim transporti për cdo ngarkesë e mjet transporti pas plotësimit të destinës dhe të dokumentit shoqërues të mallit.

7. Raporton me shkrim dhe bën rakordimet me Drejtorisë së Buqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota, Bashkia Vlorë çdo 15 ditor për sasinë e materialit drusor të prodhuar, atij që është gjëndje në ngastër, që është sistemuar në rrugë auto dhe të transportuar.

8. Pavarësisht nga pagesa e bërë, nuk fillon prerjen e materialit drusor në pjesën pasardhëse, pa përfunduar detyrimet e shfrytëzimit në pjesën paraardhëse.

9. Mbron sipërfaqen që shfrytëzon nga prerjet abusive e zjarret dhe mban përgjegjësi ligjore për dëmtimet e saj.

10. Merr pjesë aktive me forcat dhe mjetet e veta për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, që ndodhen në ekonominë pyjore ku ushtron aktivitetin.

11. Bën sigurimin teknik të punonjësve të tij, Mban përgjegjësi ligjore për mbrojtjen dhe sigurimin në punë të punonjësve të vet. Për cdo ngjarje e aksident në ngastrën pyjore ku ai punon merr masa, nderpret punën dhe njofton Drejtorisë së Buqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullota, Bashkia Vlorë .

12. Deklaron me përgjegjësi cdo fund muaji në tatim-taksa të punësuarit e tij dhe derdh për ta kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

V. VLERA E KONTRATËS DHE PAGESAT

1. Vlera tërësore e kontratës është në shumën 462.000 **(katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) Lekë.**

2. Për ngastrën, n/ngastrën nr.10ab,11b2,13abc,14,17,18ab me lëndë punimi e dru zjarri, ekonomia pyjore Kume-Shashicë me vëllim deri 1000 m3, subjekti bën pagesën e plotë para fillimit të prerjes, në shumën 462.000 **(katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë** në datën 09.04.2025. Kur nuk respektohet kjo kërkesë, subjekti paguan për cdo ditë vonesë kamate 0.1% të vlerës së këtij kësti.

3. Për ngastrën, n/ngastrën nr. _____ me lëndë punimi e dru zjarri, ekonomia pyjore _____ me vëllim mbi 1000 m³, subjekti bën pagesën me dy këste, si me poshtë:

a. Kësti i parë _____ lekë, në datën _____. Kur nuk respektohet kjo kërkesë subjekti paguan për çdo ditë vonesë kamate 0.1% të vlerës së këtij kësti.

b. Kësti i dytë _____ lekë, në datën _____, i cili do të jetë 4 muaj para përfundimit të kontratës. Kur nuk respektohet kjo kërkesë Bashkia ndërpret kontratën, lënda drusore në këmbë e mbetur e paprerë sekuestrohet dhe pas inventarizimit të saj, i nënshtrohet shitjes në ankandin e radhës.

VI. SANKSIONET

1. Kur subjekti shkel kushtet e kontratës dhe veprimet e tij nuk përbëjnë shkelje të ligjit nr. . 57/20 datë 30.04.2020 “Për Pyjet ” të paguajë gjobë:

- Për mos pastrimin brenda afatit fillestar të përcaktuar në kontrate, të sipërfaqes (pjesës) ngastrës së trajtuar, 20 000 lekë për ha.
- Për mos prerjen rrafsh me tokën të drurëve me diametër deri 15 cm, dhe në lartësinë më të vogël se 1/3 e diametrit për drurët me diametër mbi 15 cm, 200 lekë për dru të prerë në këtë mënyrë.
- Përvec gjobës së parashikuar në gërmat (a) dhe (b) subjekti detyrohet të bëjë edhe pastrimin e pjesëve, korigjimin e prerjeve në lartësinë e kërkuar dhe prodhimin e druve të zjarrit brenda një afati të ri. Në rast të kundërt atij i humbet e drejta e pjesëmarrjes në ankandet dhe tenderat e tjerë për një vit dhe i propozohet QKL për heqjen e licences.
- Për lënien pa prerë të materialit drusor të damkosur dhe për mos prodhimin e druve të zjarrit, që rezultojnë sipas zbatimit të skemës teknologjike të shfrytëzimit njëfishin (1) e shumë përkatëse, sipas tarifave bazë të shitjes së lëndës drusore në këmbë.
- Për lënien pa prerë të materialit drusor të damkosur dhe për mos prodhimin e lëndës së punimit e druve të zjarrit, që rezultojnë gjatë shfrytëzimit, brenda afatit të përcaktuar në kontratë, humbet të drejtën e prerjes së materialit drusor të mbetur dhe detyrohet të paguajë sanksion në masën 50% të sasisë së mbetur pa u prerë sipas tarifave bazë, atij i rishitet kjo sasi pa ankand. Në rast refuzimi të riblerjes, atëhere materiali drusor i nënshtrohet shitjes me ankand dhe subjektit i humbet e drejta e pjesëmarrjes në ankandet e tjerë për një vit dhe i propozohet QKL për heqjen e licences.
- Për mos transportin e materialit drusor nga pylli (ngastra) për në destinacionin përfundimtar brenda afateve të përcaktuara në kontrate, humbet të drejtën e transportit të materialit drusor të mbetur.
- Për mos marketimin e materialit drusor dhe plotësimit të distins në dokumentin shoqërues të mallit, të konstatuar gjatë transportit të tij nga pylli (ngastra) për në destinacionin përfundimtar të paguajë gjobë në masën 80 000 lekë për mjet transporti.
- Materiali drusor i prerë, i rrëzuar dhe i asortuar, që ndodhet brenda ngastrave dhe ai i stivosur në rrugë auto, pas afateve të përcaktuara në kontratë sekuestrohet. Në fillim ai i ofrohet për blerje subjektit të cilit i është sekuestruar, në bazë të tarifave të shitjes së lëndës drusore në këmbë. Në rast refuzimi nga ana e tij, atëhere materiali drusor i nënshtrohet shitjes me ankand dhe subjektit i humbet e drejta e pjesëmarrjes në ankandet e tjerë për një vit.
- Për materialin drusor të sekuestruar sipas gërmës (i) kur ai do të shitet në ankand, vlera e shitjes përcaktohet nga Bashkia me komision, duke marrë si bazë vlerën e lëndës drusore në këmbë sipas tarifave në fuqi, plus shpenzimet e kryera nga subjekti deri në momentin e sekuestrimit.

2. Kur veprimet e subjektit përbëjnë shkelje të nenit 36 të ligjit 57/20 datë 30.04.2020 “Për Pyjet” si: prerje pa damkë, dëmtim filizërie, transport materiali drusor pa vërtetim transporti etj, ai përgjigjet sipas dispozitave të këtij ligji dhe i propozohet QKL për heqjen e licensës.

VII. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE E KONTRATËS

1. Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontratë, zgjidhen me mirëkuptim të palëve, në të kundërt në Gjykatën Administrative Lushnje..
2. Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj vetëm atëhere kur nuk janë respektuar detyrimet kontraktore.
3. Për ceshtjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme, do të zbatohen dispozitat e ligjit të pyjeve dhe të Kodit Civil.
4. Kjo kontratë hartohet në tre kopje, nga të cilat një e merr subjekti “Merilin Gjini” dhe dy kopje i mban Bashkia Vlorë.

PALET

Për Subjektin

“Merilin Gjini”

Përfaqësuesi

Valentin Gjini



Për Bashkinë Vlorë

KRYETARI

Ermal Dredha

